

LIGJ

PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E REZERVAVE MINIMALE TË SIGURISË TË NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ¹

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj përcakton detyrimet për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit me naftë bruto dhe nënprodukte të saj në Republikën e Shqipërisë.
2. Ky ligj siguron bazën për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj. Ky ligj rregullon procedurat e nevojshme për përdorimin e rezervave të sigurisë në rast të reduktimit të papritur deri në mungese të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto.
3. Ky ligj ka si qëllim krijimin e Agjencisë përgjegjëse për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënprodukte të saj.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agjencia" është Agjencia përgjegjëse e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, e autorizuar për të blerë, magazinuar, menaxhuar dhe shitur rezervat e sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë përfshirë dhe rezervat specifike.
2. "INSTAT" është Instituti i Statistikave.

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën 2009/119/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2009, "Mbi vendosjen e detyrimit tek Vendet Anetare për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe/ose nënproduktet e saj", e cila shfuqizon direktivën 73/238/EEC dhe Direktiven 2006/67/EC

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën 2009/119/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2009, "Mbi vendosjen e detyrimit tek Vendet Anetare për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe/ose nënproduktet e saj", e cila shfuqizon direktivën 73/238/EEC dhe Direktiven 2006/67/EC

3. "Objekt depozitues" është rezervuari bashke me instalimet përkatëse që plotësojnë kushtet ligjore dhe teknike të përcaktuar nga autoritetet, për mbajtjen e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
4. "Marrëveshje dypalëshe" është një marrëveshje e veçantë ndërkombëtare, për ruajtjen e rezervave të sigurisë të naftës dhe nënprodukteve të Republikës së Shqipërisë ose të vendeve anëtarë BE / Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, në territorin e çdo vendi anëtar të BE / Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Marrëveshja dypalëshe do të përdoret për rezervat fizike dhe të deleguara të sigurisë.
5. "Ministër" është ministri përgjegjës për hidrokarburet.
6. "Ministria" është ministria përgjegjëse për hidrokarburet.
7. "Ndërprerje e madhe në furnizim" është rënie e konsiderueshme dhe e papritur në furnizimin e naftës bruto ose nënprodukteve të saj në vendet anëtare të BE/Komunitetit të Energjisë, pavarësisht nëse është marrë apo jo një vendim ndërkombëtar për përdorimin e rezervave të sigurisë.
8. "Ndërprerje lokale në furnizim" është një rënie e konsiderueshme dhe e papritur në furnizimin e produkteve të naftës në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nëse për këtë është marrë apo jo një vendim ndërkombëtar për përdorimin e rezervave të sigurisë.
9. "Niveli i rezervave të sigurisë" janë rezervat fizike të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj të magazinuara për qëllimi të këtij ligji dhe të shprehura në numër ditësh të importeve neto ose konsumit të brendshëm.
10. "Operatori Ekonomik" është subjekt juridik që kryen veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe që ka leje përkatëse të lëshuar nga autoriteti kompetent për një ose disa nga veprimtaritë e mësipërme.
11. "Plani Kombëtar i Reagimit" është Plani i Veprimit i masave dhe aktiviteteve të Agjencisë dhe organeve të tjera qeveritare dhe operatoreve ekonomike, të cilat do të ekzekutohen pasi Këshilli i Ministrave të shpallë gjendjen e emergjencës së ndërprerjes të furnizimit.
12. "Produkte energjetike hidrokarbure" janë: Nafta bruto, gaz natyror i lëngëzuar, lende të para për rafineritë, aditivë/oksigjenate, hidrokarbure të tjera, gaz rafinerie (jo i lëngshëm), etan, gaz i lëngshëm i naftës, virxhin naftë, benzinë automjetesh, benzinë mjetesh fluturimi ajror, benzinë karburanti lloj jet (vajguri karburantit lloji reaktiv ose JP4), kerozine jet, kerozine tjetër, gazoil/diezel, diezel automjetesh, gazoil për ngrohje dhe përdorim tjetër, solar (me përmbajtje të ulet dhe të lartë squfuri), ëhite spirit dhe SBP, lubrifikantë, bitum, dyll parafine, koks naftë dhe produkte të tjera.
13. "Produktet shtese" janë përbërësit jo-hidrokarbure që i shtohen ose përzihen me një produkt për të modifikuar karakteristikat e tij.
14. "Biokarburante" janë lëndë djegëse për sektorin e transportit, në trajtë të lëngët ose të gaztë, të cilat prodhohen nga biomasa. "Biomasa" është pjesë e produkteve të

dekompozuara, mbeturina dhe mbetje nga agrikultura (duke përfshirë substancat bimore dhe shtazore), pyjet dhe industrinë e lidhura me të, si dhe pjesës të dekompozuara nga mbetjeve industriale dhe komunale.

15. "Rezervat e sigurisë të deleguara" janë rezervat e sigurisë të mbajtura nga një person tjetër juridik në favor të Agjencisë ose ndonjë organi tjetër përfitues, i cili ka një detyrim për mbajtjen e rezervës së sigurisë, për një periudhë të përcaktuar dhe që garanton mundësisë ekskluzive për t'u blerë nga Agjencia në rast të ndërprerjes së furnizimit.
16. "Rezervat e sigurisë të naftës dhe/ose nënprodukteve të saj" janë sasi të rezervave të naftës dhe nënprodukteve të saj të krijuara sipas këtij ligji, për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit të Republikës së Shqipërisë dhe për të përmbushur detyrimet e marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.
17. "Rezervat specifike" janë rezervat e nënprodukteve të naftës që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
18. "Rezervat tregtare" janë ato rezerva të produkteve energjetike hidrokarbure të mbajtura nga operatorët ekonomik dhe që nuk janë objekt i këtij ligji.
19. "Sekretariati i Komunitetit të Energjisë - SKE" është institucioni i Komunitetit të Energjisë që funksionon në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
20. "Tarifa e mbajtjes së rezervës së sigurisë" është tarifa e mbledhur për financimin e krijimit dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë.
21. "Tarifë paguesi" është paguesi i akcizës për naftën bruto dhe nënproduktet e saj. Në rast se nuk ka akcizë për produktin, atëherë paguesi i tarifës është operatori ekonomik që tregton naftë bruto dhe nënproduktet e saj në tregun vendas.
22. "Vendimi për përdorimin e rezervave të sigurisë" është çdo vendim i vlefshëm i marrë nga Këshilli i Ministrave për të nxjerre produkte energjetike hidrokarbure në dispozicion të tregut, duke përdorur rezervat e anëtarëve të Komunitetit të Energjisë dhe duke marrë masa shtesë nëse është e nevojshme.
23. "Vështirësi në furnizim" është një rënie e konsiderueshme dhe e menjëhershme në furnizimin e produkteve të energjisë në një Shtet Anëtar të Komunitetit të Energjisë apo të Bashkimit Evropian, e cila mund të shoqërohet me një vendim efektiv ndërkombëtar për përdorimin e rezervave të sigurisë.
24. "Viti referues" - do të thotë viti kalendarik i të dhënave të konsumit apo të importit neto të përdorura për të llogaritur rezervat që do të mbahen ose rezervat e mbajtura në një kohë të caktuar.
25. "Konsumi vendas" – është sasia totale e llogaritur sipas nenit 4, e lëvruar brenda vendit për përdorim energjetik dhe jo energjetik; ky total përfshin lëvrimin tek sektori industrial, transportit, rezidencial dhe sektorë të tjerë për konsum final; përfshin gjithashtu dhe konsumin vetjak të sektorit energjetik (përveç lendeve djegëse për rafinerinë);

KAPITULLI II

KRIJIMI, MENAXHIMI , RUAJTJA, LLOGARITJA DHE RAPORTIMI STATISTIKOR I REZERVES SË SIGURISE

Neni 3

Detyrimi i ruajtjes së rezervave të sigurisë

1. Ky ligj ofron bazën për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj.
2. Rezervat e sigurisë krijohen dhe mbahen për të siguruar furnizim të pandërprerë të tregut me produkte energjetike hidrokarbure.
3. Rezervat e sigurisë nënkuptojnë sasinë e produkteve energjetike hidrokarbure të cilat janë në dispozicion ose nën kontrollin e institucioneve shtetërore dhe të cilat janë krijuar për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit në vend, për të ruajtur sigurinë kombëtare, për të kryer detyrime të pranuar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për të garantuar jetesën normale për popullatën.

Neni 4

Krijimi i rezervave të sigurisë

1. Shuma e përgjithshme e rezervave të sigurisë në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë të paktën 90 ditë mesatare ditore të importeve neto ose të paktën 61 ditë të mesatares ditore të sasisë të konsumit të brendshëm, cilado nga dy sasinë është më e madhe. Rezervat e sigurisë krijohen gradualisht dhe në mënyrë proporcionale në baze të Planit të Veprimit (më tej "plani i veprimit"), të përmendur në nenin 11 të këtij ligji dhe jo më vonë se data 31 dhjetor 2022.
2. Mesatarja ditore e importeve neto llogaritet në bazë të ekuivalentimit në naftë bruto të importeve të produkteve energjetike hidrokarbure gjatë vitit paraardhës kalendarik. Mesatarja ditore e konsumit të brendshëm llogaritet në bazë të ekuivalentimit në naftë bruto të produkteve energjetike hidrokarbure me konsumit të brendshëm gjatë vitit paraardhës kalendarik. Metoda e llogaritjes përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Pavarësisht nga pika 2 e këtij neni, gjatë periudhës prej 1 janarit deri më 31 mars të çdo viti kalendarik, detyrimi i mbajtjes së rezervave të sigurisë për vitin përkatës kalendarik përcaktohet në bazë të të dhënave të vitit të fundit, para një viti të vitit në fjalë.

Neni 5

Përbërja e rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

1. Jo më vonë se data 1 prill të çdo viti, me propozim të Agjencisë, Ministri përcakton në programin vjetor kategoritë e rezervave të sigurisë midis naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, e cila është e vlefshme deri më 31 mars të vitit pasardhës.
2. Në çdo kohë rezervat e sigurisë përbëhen të paktën nga produktet kryesore energjetike hidrokarbure në vijim:
 - Naftë bruto
 - Gazoil (Diezel)
 - Benzinë automjetesh
 - Lende djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene)
3. Përveç produkteve kryesore energjetike hidrokarbure të listuar në piken² të këtij neni, rezervat e sigurisë mund të përfshijnë: GLN, GNL, , gazi i rafinerisë (jo i lëngshëm), etan, ëhite spirit, benzine avionësh (jetfuel), tipe të tjera kerozene, solar, bitum, vajrat lubrifikantë dyllë parafine dhe koks i naftës.
4. Agjencia duhet të sigurojë që në çdo kohe:
 - a. Jo më shumë se 50 për qind e sasisë vjetore të rezervave se sigurisë në pronësi të Agjencisë përbëhet nga naftë bruto.
 - b. Të paktën një e treta e rezervave të sigurisë vjetore të mbahet në formën e nënprodukteve të naftës bruto, shuma e konsumit të cilave, gjatë vitit referues përben të paktën 75 për qind të konsumit të brendshëm që i referohet Neni 4 pika 2. Përqindja e nënprodukteve të naftës bruto të përmendura më lart, do të përcaktohet duke marrë parasysh përqindjet individuale në shumën totale të importeve neto të produkteve energjetike hidrokarbure gjatë vitit kalendarik të mëparshëm.
- 5 Biokarburantet dhe produktet shtese duhet të konsiderohen në llogaritjen e shumave aktuale të rezervave të sigurisë vetëm kur ata kanë qenë të përzier me nënproduktet e naftës bruto në fjalë. Biokarburantet dhe produktet shtese duhet të merren në konsideratë në qoftë se është e garantuar se ata janë të përzier me nënproduktet e naftës bruto të depozituara si rezerva të sigurisë dhe së bashku me ta do të ruhen në të njëjtën depo ose magazina të cilat janë të lidhura me instalime funksionale. Biokarburantet do të merren në konsideratë vetëm kur ata do të përdoren në transport, në masën në të cilën ato mund të jenë të përzier me produktet ekzistuese të naftës, sipas specifikimeve teknike.

Neni 6

Rezervat e deleguara

1. Rezervat e sigurisë sipas neni 5, të këtij ligji mund të mbulohen pjesërisht nga një marrëveshje me afat të caktuar, ku sipas të cilës një person tjetër juridik merr përsipër

detyrimin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë dhe fiton të drejtën për të blerë sasi të rezervave të sigurisë të mbuluara nga marrëveshja dhe këtu e më poshtë në këtë ligj do të quhen "rezervat e deleguara".

2. Në rast të vështirësive në furnizimin, Agjencia ka të drejtë:
 - a. t'i kërkojë personit juridik në pikën 1 të këtij Neni të shesë rezervat e deleguara tek Agjencia ose persona të tjerë të përcaktuara nga Agjencia ose
 - b. në rast se mbajtësi i rezervës së sigurisë është një Operator Ekonomik, prej të cilit Agjencia do të krijojë Rezervën e Sigurisë në përputhje me Nenin 5 të këtij Ligji, të lejojë këtë Operator të përdorë shumën e specifikuar të rezervave të deleguara.
3. Marrëveshja për rezervat e deleguara duhet të parashikojë të paktën sa më poshtë:
 - 1) të drejtën ekskluzive të Agjencisë për të blerë sasi të rezervave të deleguara në çdo kohë gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes;
 - 2) metodën për përcaktimin e çmimit të pagueshëm për rezervat në rast të blerjes së tyre;
 - 3) vendndodhjen e depozitave ku mbahen rezervat e deleguara dhe sasi të përkatëse;
 - 4) afatin e marrëveshjes;
4. Marrëveshja për rezervat e deleguara nënshkruhet midis Agjencisë dhe personit juridik dhe/ose operatorit ekonomik dhe miratohet nga Ministri përgjegjës për hidrokarburet.

Neni 7

Marrja e të dhënave për llogaritjen e detyrimit të mbajtjes së rezervave të sigurisë

1. Për llogaritjen e mesatares ditore të importeve neto të produkteve energjetike hidrokarbure të kërkuar sipas nenit 5, Agjencia merr të dhëna nga Autoriteti Doganor.
2. Për llogaritjen e mesatares ditore të konsumit të brendshëm të produkteve energjetike hidrokarbure të kërkuar sipas nenit 5, Agjencia merr të dhëna nga institucioni i ngarkuar për hartimin e bilancit energjetik kombëtar.
3. Të dhënat vjetore të kërkuara sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni do të vihen në dispozicion të Agjencisë jo më vonë se data 1 shkurt të çdo viti.

Neni 8

Sasi të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e rezervave të sigurisë

Sasi të cilat nuk përfshihen në llogaritjen e rezervave të sigurisë janë si më poshtë:

1. Rezervat që mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në emër të Shteteve të tjera Anëtare të Komunitetit të Energjisë.
2. Rezervat tregtare të mbajtura nga operatorët ekonomikë, të cilët nuk janë të detyruar të mbajnë pjesë të rezervave të sigurisë si të tilla sipas këtij ligji.
3. Naftën bruto ende të pa prodhuar.
4. Produktet energjetike hidrokarbure të ruajtura në:
 - a. tubacione;
 - b. cisternat hekurudhore;
 - c. stacionet e shitjes së karburanteve dhe njësive të lendeve djegëse;
 - d. nga konsumatorë të tjerë;
 - e. rezervat ushtarake;
 - f. anije në det;

Neni 9

Llogaritja e sasisë së rezervave të sigurisë

Sipas të dhënave vjetore, Agjencia i paraqet Ministrit propozimin për sasinë e rezervave të sigurisë për vitin aktual, jo më vonë se data 1 Mars të çdo viti. Propozimi për sasinë e rezervës së sigurisë përcakton:

- a. Sasi të e produkteve energjetike hidrokarbure në ton, që do të miratohen për t'u mbajtur si rezerve sigurie për vitin aktual.
- b. Struktura e rezervës së sigurisë për vitin aktual sipas nenit 5.

Metodologjia dhe procedurat për llogaritjen e detyrimeve për rezervat e sigurisë sipas këtij neni përcaktohen me Udhëzim të Ministrit.

Neni 10

Raportimi

1. Rafineritë e përpunimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe shoqëritë e tregtimit me shumice të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj duhet të raportojnë në Agjenci brenda datës 15 të muajit aktual, të dhënat që lidhen me rezervat e sigurisë dhe rezervat tregtare të cilat janë mbajtur gjatë muajit paraardhës. Ministria përcakton formën dhe mënyrën e paraqitjes së të dhënave.

Agjencia mban dhe përditëson vazhdimisht të dhënat e detajuara të të gjitha rezervave të sigurisë të cilat ajo mban dhe të gjitha rezervave të cilat mbahen në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe, për të cilën përgatit një regjistër të veçante.

Të dhënat duhet të përmbajnë veçoritë në lidhje me vendndodhjen e magazinave, si dhe informacion për secilin objekt magazinimi, në lidhje me produktet energjetike hidrokarbure të

ruajtur në atë objekt, sasitë përkatëse të rezervave të sigurisë dhe pronarët e rezervave të sigurisë.

Agjencia, para datës 20 shkurt të çdo viti, i paraqet Ministrisë një raport të detajuar të rezervave të sigurisë, në të cilën janë shënuar sasitë, kategoritë e produkteve energjetike hidrokarbure dhe llojet e rezervave të sigurisë të përfshira në regjistrin, deri në ditën e fundit të vitit kalendarik të mëparshëm.

Ministria paraqet pranë Këshillit të Ministrave dhe SKE raport të përmbledhur për gjendjen e rezervave të sigurisë para datës 25 Shkurt të cdo viti.

Në fund të çdo muaji Agjencia paraqet në INSTAT një përmbledhje statistikore lidhur me rezervat e mbajtura të sigurisë duke u mbështetur në pikën 1 të këtij neni. Përmbledhja statistikore paraqitet deri në ditën e 25 të muajit që pason muajin e raportimit.

2. Agjencia ruan të gjitha të dhënat, përmbledhjet dhe dokumente të tjera që lidhen me rezervat e sigurisë të paktën për pesë vjet, duke filluar nga momenti që ata janë mbledhur ose krijuar.

3. Për të verifikuar pagesën e tarifës së rezervës, deri në ditën e fundit të çdo muaji, Autoriteti Doganor i paraqet një informacion Agjencisë lidhur me sasitë e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj të hedhur për konsum gjatë muajit të mëparshëm kalendarik. Raporti përkatës mujor do të vihet në dispozicion të Agjencisë jo më vonë se brenda 30 ditëve, për importin e përfunduar në ditën e fundit të muajit.

4. Agjencia dërgon cdo muaj pranë Ministrisë një përmbledhje statistikore të nivelit të rezervës së sigurisë që gjendet në ditën e fundit të cdo muaji kalendarik e llogaritur në baze të numrit të ditëve të importit neto ose në bazën e numrit të ditëve të konsumit vendas siç janë parashikuar në Nenin 4. Ky raport do dërgohet brenda 5 ditëve nga përfundimi i muajit që janë bere këto llogaritje.

5. Në rast të mbajtjes së rezervës specifike, Agjencia duhet të informoje Ministrinë mbi nivelin e kësaj rezerve, produktet e përzgjedhura dhe periudhën e mbajtjes së kësaj rezerve, e cila duhet të jete minimalisht 1 vit. Ky raport duhet të dërgohet brenda 30 ditëve nga përfundimi i muajit që i referohet

6. Për të përcaktuar pjesën e tregut të operatorëve ekonomikë, Agjencia ka të drejtë të marrë informacion nga Autoriteti Doganor për të siguruar gatishmërinë për hedhjen në treg të rezervave të sigurisë.

Neni 11

Rregullat për përcaktimin e sasisë dhe strukturës së rezervave të sigurisë

1. Krijimi, mbajtja dhe ripërtëritja e rezervave të sigurisë behet nga Agjencia duke zbatuar rregullat e mëposhtme:

1.1. Plani i veprimit për krijimin e rezervave të sigurisë,

1.2. Vendimi mbi sasinë dhe strukturën e rezervave të sigurisë për vitin e ardhshëm,

1.3. Programi vjetor, duke përfshirë edhe planin financiar për vitin e ardhshëm,

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton një plan veprimi për krijimin e rezervave të sigurisë.

Plani i veprimit përcakton dispozitat kalimtare për krijimin e rezervës së sigurisë dhe:

2.1. nivelet minimale në të cilën rezervat e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj të ruhen, në fund të çdo viti kalendarik deri më 31 dhjetor 2022 dhe në përputhje me nenin 24.

2.2 se që nga 1 janari 2023, rezerva e sigurisë të mbahet në nivelin e parashikuar në nenin 4 të këtij ligji.

3. Ministri, me propozim të Agjencisë, përpara datës 15 mars të çdo viti përcakton sasinë dhe strukturën e rezervës të sigurisë siç përcaktohet në nenin 5 të këtij ligji, të cilat duhet të mbahen në bazë të sasisë të importeve neto apo konsumit të brendshëm të vitit paraardhës, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji dhe pikën 2 të këtij neni.

4. Në bazë të pikës 3 të këtij neni dhe në përputhje me Planin e Veprimit të referuar në pikën 2 të këtij neni, Këshilli Drejtues i Agjencisë, para datës 31 mars të këtij viti, miraton programin vjetor duke përfshirë edhe planin financiar i cili rregullon krijimin dhe ripërtëritjen e rezervave të sigurisë. Në rast se ndonjë ndryshim i rëndësishëm në totalin e shpenzimeve pritet të kalojë 10% të programit të miratuar gjatë vitit aktual, Këshilli Drejtues shqyrton programin e rishikuar vjetor në përputhje me rrethanat.

Neni 12

Mbajtja e rezervave të sigurisë

1. Mbajtja e rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe nënproduktet e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë përbën prioritet të veçantë.

2. Një pjesë e rezervave të sigurisë mund të ruhen jashtë territorit shqiptar në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe / ose nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në bazë të një marrëveshje paraprake dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe shtetit në të cilin rezervat e detyrueshme e sigurisë duhet të ruhen.

3. Rezervat e sigurisë që janë në pronësi të Shtetit Shqiptar duhet të jenë të siguruara në çdo kohë nga një shoqëri sigurimesh lidhur me demet ndaj pronës.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për çdo humbje të rezervave të sigurisë, për të cilat është titulluar për mbajtjen e tyre dhe dëmeve ndaj të tretëve dhe mjedisit.

Neni 13

Disponueshmëria e rezervës

1. Rezervat e sigurisë dhe ato specifike duhet të jenë të disponueshme në çdo kohë për qëllimet e këtij ligji. Rezervat e sigurisë janë të përjashtuara si subjekt i barrës hipotekore, pengut, shtrëngimit dhe konfiskimit.
2. Agjencia dhe Operatorët Ekonomikë duhet të sigurojnë që rezervat e sigurisë dhe ato specifike duhet të jenë në çdo kohë fizikisht të përdorshme dhe nuk lejohet të transferohen nga objektet depozituese të caktuara për mbajtjen e rezervave të sigurisë, pa miratimin paraprak të Agjencisë.
3. Rezervat e sigurisë të ruajtura në territorin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjes dypalëshe për çdo shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Komunitetit të Energjisë, nuk duhet të jenë subjekt i barrës hipotekore, pengut, shtrëngimit dhe konfiskimit.
4. Rezervat e sigurisë të ruajtura në territorin e Republikës Shqipërisë në bazë të marrëveshjes dypalëshe me shtetet e tjera anëtare të SKE, për llogari të të cilit rezervat janë mbajtur nën këtë marrëveshje, duhet të transferohen pa pengesa tek shteti zotërues, në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i rezervave të sigurisë

1. Operatorët Ekonomikë, të kontraktuar për ruajtjen e rezervave të sigurisë në objektet e tyre depozituese, janë të detyruar të jene të pajisur me lejen e duhur për tregtimin me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
2. Operatoret ekonomike janë të detyruar të mirëmbajnë cilësinë e rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në përputhje me rregullat mbi cilësinë e këtyre produkteve në Republikën e Shqipërisë dhe të mos përmbajnë përbërës të ndaluar dhe/ose papastërti, që mund të ndikojnë në cilësinë dhe në sasitë aktuale të rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.
3. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar që të lejojnë inspektimin pa asnjë lloj pengese të Agjencisë dhe organet fiskale dhe përfaqësuesve të autorizuar të tyre. Përfaqësuesit e Agjencisë, në çdo kohë, bëjnë verifikimin e cilësisë dhe sasisë në objektet e magazinimit dhe sigurojnë dokumentacionin e plotë lidhur me rezervat e sigurisë. Në këtë proces merret në konsiderate vetëm ndryshimi i gjendjes për shkak të firove të miratuara që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë por në cdo rast, operatoret ekonomike duhet të mbajnë rezervën e sigurisë në nivelin e kërkuar në përputhje me nenin.
4. Agjencia dhe Operatorët Ekonomikë që mbajnë rezervat e sigurisë, janë të detyruar të lejojnë përfaqësuesit e autorizuar nga Ministria për të kontrolluar dokumentet që kanë të bëjnë me rezervat e sigurisë si dhe magazinat dhe vendet ku mbahen rezervat e sigurisë.

5. Rezervat e sigurisë depozitohen vetëm në magazina të cilat plotësojnë kushtet, normat teknike dhe ato të sigurisë që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
6. Mbajtja dhe menaxhimi i rezervave të sigurisë nga operatorët ekonomike behet sipas rregullave teknike të miratuar nga Ministri.
7. Operatorët Ekonomikë që ruajnë dhe mbajnë rezervat e sigurisë janë të detyruar të mbajnë të gjitha dokumentet dhe të dhënat për llojin, sasinë, cilësinë dhe vendndodhjen e rezervave për të paktën pesë vjet nga data e krijimit ose modifikimit të tyre.

KREU III

Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë

Neni 15

Agjencia për rezervat e sigurisë të naftës dhe nënprodukteve të saj

1. Agjencia Shtetërore e Rezervave të Sigurisë të Naftës (ASHRSN) është institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë—në këtë ligj do ti referohet "Agjencia". ASHRSN është i vetmi organ në Republikën e Shqipërisë, i cili është i autorizuar për të blerë, të magazinoje, të menaxhoje dhe të tregtoje rezervat e sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukte të saj, për qëllime të këtij ligji.

Neni 16

Statusi ligjor

1. Agjencia është person juridik publik jofitimprurëse, në varësi të Ministrisë dhe organizohet si Drejtori e Përgjithshme, në nivel qendror me seli në Tiranë. .
2. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e detajuara të Agjencisë miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit.
3. Agjencia, mund, për një periudhe kohe të caktuar, të delegeje detyra që lidhen me menaxhimin e rezervës së sigurisë dhe, me përjashtim të shitjes dhe blerjes, të rezervave specifike por vetëm tek nje vend anëtar i BE/SKE ku ndodhen këto rezerva ose tek operator ekonomik.
4. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i Drejtori të Përgjithshëm bëhet me Urdhër të Kryeministrit me propozim të Ministrit.
5. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen nga Kodi i Punës.

6. Të gjitha rezervat e sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj që mbahen nga Agjencia dhe ato në emër të saj, për qëllime të këtij ligji, përjashtohen nga akcizat, doganat, taksat e tjera dhe detyrimet e TVSH-së, derisa nuk janë hedhur në treg.
7. Agjencia duhet të funksionojë sipas parimit të vetëfinancimit.

KAPITULLI IV

BURIMET FINANCIARE TË AGJENCISËNeni 17

Metodat e financimit

1. Fondet e dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për krijimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, inspektimin e rezervave të sigurisë, si dhe për aktivitetet e tjera të rregullta të agjencisë, sigurohen nga:
 - 1.1 Tarifat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë që aplikohen mbi sasi të produkteve energjetike hidrokarbure që shiten në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 11;
 - 1.2 Kredi të mundshme të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 1.3 Të ardhurat nga shitja e rezervave;
 - 1.4 Të ardhurat nga shitja e shërbimeve;
 - 1.5 Burime të tjera.
2. Fondet nga pikën 1 i këtij neni, paguhen në llogarinë e Agjencisë.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, vendos tarifën e përmendur në pikën 1.1 të këtij neni. Shuma e tarifave mbi produktet energjetike hidrokarbure në lekë / litër ose leke / kg për çdo kategori të produkteve energjetike hidrokarbure (ose e përbashkët për të gjitha kategoritë) sipas nenit 5, përcaktohet në bazë të nevojave të financimit për vitin fiskal përkatës për aktivitetin e Agjencisë.
4. Fondet e papërdorura nga viti i kaluar mbarten për përdorim për vitin e ardhshëm.
5. Nëse shuma totale e tarifës të përmendur në pikën 1.1 të këtij neni, paguar brenda një viti kalendarik tejkalon kostot aktuale të menaxhimit të rezervave të sigurisë në atë vit kalendarik, shuma e marrë në tejkallim të kostove mbahet parasysh në vendosjen e ardhshme të nivelit të kësaj tarife.

Neni 18

Personat e detyruar për pagesën e tarifës

1. Tarifat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë, për detyruesit në bazë të pikës 1.1 të nenit 17, paguhen në llogarinë e Agjencisë, në momentin e hedhjes në qarkullim të lirë arkëtohen nga Autoriteti Doganor gjatë mbledhjes së detyrimit doganor të mallrave me akcizë dhe paguhen në llogarinë e Agjencisë.

2. Paguesit e tarifës së sigurisë janë të detyruar që brenda afatit prej 30 ditësh pas përfundimit të muajit kalendarik në të cilin paguhet pagesa e kësaj tarife, të dorëzojnë të dhënat në lidhje me pagesën e realizuar pranë Agjencisë.

KREU V

REZERVAT SPECIFIKE

Neni 19

Rezervat specifike

1. Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë një vendim me të cilin vendos krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike, si pjesë e rezervave të sigurisë të përmendura në nenin 5 të këtij ligji.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave duhet të përfshijë një listë të produkteve energjetike hidrokarbure që do të përdoren për krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike, nivelin e rezervave specifike dhe kohëzgjatjen e detyrimit për të mbajtur rezervat specifike, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji.
3. Krijimi dhe mbajtja e rezervave specifike ka efekt të paktën 1 (një) vit kalendarik.

KREU V

Përdorimi i rezervave të sigurisë

Neni 20

Plani Kombëtar i Reagimit

1. Në rast të ndërprerjes së furnizimit të tregut me nënproduktet e naftës bruto, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit, merr vendim për përdorimin e rezervave të sigurisë, në përputhje me "Planin Kombëtar të Reagimit" të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
2. Në Planin Kombëtar të Reagimit duhet të përcaktohen të paktën elementet e mëposhtëm:
 - a. Arsyeja për përdorimin e rezervave të sigurisë
 - b. Afatet për lëvrimin dhe furnizimin për shitje të rezervave të sigurisë
 - c. Kushtet për përdorimin e rezervave të sigurisë
 - d. Lloji dhe sasia e nënprodukteve të naftës që do të përdoret
 - e. Veprimet e nevojshme për zëvendësimin e rezervës së sigurisë që do të përdoret
3. Në rast se rezervat e sigurisë janë përdorur, rezervat duhet të zëvendësohen në nivelin e kërkuar gjatë periudhës së rënë dakord në Planin Kombëtar të Reagimit.

4. Rregullat dhe procedurat e hartimit të Planit Kombëtar të Reagimit, përfshirë përcaktimin e çmimit të hedhjes në treg dhe mënyrën e përdorimit të rezervave të sigurisë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Bashkëpunimi me institucionet përkatëse ndërkombëtare

1. Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe SKE. Kjo përfshin të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e furnizimit të produkteve energjetike hidrokarbure në vendet e Komunitetit të Energjisë ose/dhe ato të BE , si dhe në rastet vështirësive të mëdha në furnizim dhe çështjet që lidhen me raportimin për gjendjen e rezervave të detyrueshme të Shqipërisë. Agjencia siguron mbështetje profesionale për Ministrinë në këtë bashkëpunim.
2. Ministria dhe Agjencia përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në punët dhe këshillimin profesional në organet e SKE dhe / ose Komisionit Evropian që merren me çështjet e sigurisë së furnizimit.

KREU VI

MONITORIMI

Neni 22

Organet kompetente për zbatimin e monitorimit

1. Monitorimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve për depozitimin dhe përtëritjen e rezervave të sigurisë kryhet nga Ministria dhe Agjencia.
2. Personat e autorizuar nga Agjencia dhe Ministria, sipas rastit, kryejnë aktivitetet e monitorimit dhe marrin masa në bazë të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj apo ndonjë akt tjetër në lidhje me:
 - 2.1. Monitorimin për zbatimin e kontratave për magazinimin e rezervës së sigurisë
 - 2.2. Shqyrtimin dhe kontrollin e dokumentacionit dhe dëshmive për pagesën e tarifave për mbajtjen e rezervës së sigurisë për detyruesin e pagesës së tarifës në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;
 - 2.3. Shqyrtimin e dokumentacionit dhe dëshmive të Operatorëve Ekonomikë që kanë të bëjnë me përdorimin, ruajtjen dhe aktivitetet e tjera në lidhje me rezervat e sigurisë të marra në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret në fuqi.

3. Personat e autorizuar nga pika 2 e këtij neni, të kryejnë detyrat e monitorimit dhe të marrin masa për të cilat janë të autorizuar me këtë ligj dhe të tjera akte nënligjore, në bashkëpunim me organet inspektuese të autorizuar dhe / ose kontrollin e trupave inspektuese të laboratorët e akredituar, në lidhje me:

3.1. Kontrollin e sasisë së nënprodukteve të naftës të mbajtura si rezervave sigurie, dhe

3.2. Kontrollin e cilësisë së nënprodukteve të naftës të mbajtura si rezervave sigurie.

4. Gjatë monitorimit, Agjencia në bazë të marrëveshjes, mund të angazhojë dhe persona të tjerë, fizik ose juridik, nga fushat përkatëse në kryerjen e ndonjë aktiviteti profesional.

KREU VII

SANKSIONET

Neni 23

1. Gjobë në shumë prej 7 deri 10% të të ardhurave totale të vitit fiskal të mëparshëm përfshirë vitin e kryerjes së kundravajtjes, ose 50% të totalit të të ardhurave të realizuara për një periudhë më të shkurtër të vitit paraardhës të kundravajtjes, nëse në atë vit ka filluar punën një personi juridik do t'i vendoset Operatorit Ekonomik nëse ai përdor rezervat e detyrueshme në mënyrë të paautorizuar ose ndryshon fushëveprimin ose hapësirën e tyre magazinuese ose në rast se disponon produkteve të naftës nga rezervat e detyrueshme në kundërshtim me kontratën dhe me këtë ligj.

2. Gjobë në shumë prej 3 deri 7 % të të ardhurave totale të vitit fiskal të mëparshëm përfshirë vitin e kryerjes së kundravajtjes, ose 50% të totalit të të ardhurave të realizuara për një periudhë më të shkurtër të vitit paraardhës të kundravajtjes, nëse në atë vit ka filluar punën një personi juridik do t'i vendoset Operatorit Ekonomik nëse ai përdor rezervat e detyrueshme si mjet për sigurimin e aplikacioneve ndaj palëve të treta, garanci ose çdo lloj mirëmbajtje dhe sigurimi dhe si mjete ekzekutimi e konfiskimi, sipas nenit 13, pikat 1 dhe 3.

3. Gjobë në shumën prej 2.000.000 deri 3.000.000 lekë do t'i vendoset për kundërvajtje Operatorit Ekonomik, përkatësisht detyruesit për pagimin e tarifës së mbajtjes së rezervës nëse:

3.1. rezervat e sigurisë që në aspektin e cilësisë nuk i plotësojnë standardet e cilësisë në fuqi, për lëndë djegëse të lëngëta, në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbajnë përbërës të paligjshme dhe / ose papastërti që mund të ndikojnë ndjeshëm në cilësinë faktike dhe sasinë e rezervave të sigurisë në bazë të nenit 14 pika 2;

3.2. nuk i paraqet dokumentacionin e disponueshëm lidhur me rezervat e sigurisë në përputhje me nenin 14, pika 3.

3.2. nuk ofron akses në kapacitetet e magazinimit ku rezervat e sigurisë ruhen në përputhje me nenin 14, pika 4;

3.3. nuk ruan të dhënat dhe dokumentacionin lidhur me rezervat e sigurisë brenda afateve të përcaktuara sipas nenit 14, pika 7.

3.4. nuk i lejon hyrje të lirë në objektet, dokumentet, sistemet elektronike ose çdo mjet tjetër të lidhur me llogaritjen dhe pagesën e tarifës së mbajtjes së rezervave dhe nuk paraqesin dokumentacionin e plotë të kërkuar për kryerjen e monitorimit, në përputhje me nenin 22.

3.5. nuk paguan tarifën për mbajtjen e rezervat në përputhje me nenin 18 të këtij ligji;

3.6. nuk pranon masat në përputhje me Planin Kombëtar të Reagimit sipas nenit 20 të këtij ligji;

4. Gjobë në shumën prej 2,000,000 deri 3.000.000 lekë do t'i vendoset për kundërvajtje shoqërisë tregtare, respektivisht detyruesit për pagesën e tarifës për mbajtjen e rezervave nëse nuk jep informacion, jep informacione të pasakta, të paplota, jo në kohë ose jep informacion në një mënyrë të ndryshme nga ajo e parashikuar në nenin 10,pika 1 dhe nenin 18, pika 2.

5. Përveç gjobës për kundërvajtjet të parashikuar nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, personi juridik i cili ka kryer dy ose më shumë kundërvajtje brenda një viti apo ka përsëritur kundërvajtjen e parashikuar nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mund t'i vendoset një ndalim i përkohshëm në kryerjen e një veprimtarie të caktuar për një periudhë prej një viti, dhe personi përgjegjës i personit juridik për të njëjtën kundërvajtje i vendoset një ndalim i përkohshëm i kryerjes së ndonjë profesioni, veprimtaria ose detyre të caktuar deri në një vit.

6. Përveç gjobës për kundërvajtje të parashikuar nga pika 3 e këtij neni, personi juridik i cili ka kryer dy ose më shumë kundërvajtje brenda një viti, mund ti vendoset dhe një ndalim i përkohshëm për kryerjen e një aktiviteti të caktuar për një periudhë prej tre deri gjashtë muaj, dhe personit përgjegjës të personit juridik për të njëjtën kundërvajtje i vendoset edhe një ndalim i përkohshëm për kryerjen e ndonjë profesioni, veprimtarie ose detyre të caktuar për një periudhë deri në gjashtë muaj. Përveç gjobës për kundërvajtje nga pika 5 e këtij neni, personat juridikë që nuk respektojnë vendimet e Këshillit të Ministrave në rast të ndërprerjes së furnizimit mund edhe t'i vendoset një ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej tre muaj deri në një vit, dhe personi përgjegjës i personit juridik ti vendoset një ndalim i përkohshëm të kryerjes së ndonjë profesioni, veprimtaria ose detyre me kohëzgjatje të caktuar për një vit.

7. Gjobat e parashikuar në këtë nen jepen nga Agjencia.

8. Të ardhurat e përfituara nga gjobat e vena kalojnë në Buxhet të Shtetit.

9. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të Agjencisë bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ekzekutimi i gjobave bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

10. Pas kalimit të afateve të ankimit administrativ, Agjencia publikon vendimin përfundimtar apo një përmbledhje të tij.

KREU VIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24

1. Rezervat e sigurisë të çdo kategori të produkteve energjetike hidrokarbure të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji të mbahen, në çdo kohë, në përputhje me Planin e Veprimt.

2. Deri më 31 dhjetor 2022, operatorët që detyrohen sipas pikës2te neni 9 të Ligjit nr. 8450, date 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, duhet të mbajnë rezerve sigurie të barabarte me 30 dite mesatare shitje në tregun e brendshëm, të veprimtarisë të një viti të mëparshëm. Kjo rezerve sigurie konsiderohet si pjesë e rezervave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Kushtet dhe procedurat e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë të përcaktuar në këtë pike të bëhen në përputhje me ligjin 8450, date 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
3. Deri në datën e përcaktuar në pikën2 të këtij neni, operatorët ekonomike deri në ditën e pestë të çdo muaji të paraqesin pranë Agjencisë një përmbledhje statistikore në lidhje me rezervat ekzistuese deri në fund të muajit paraardhës. Format i dhe lloji i të dhënave që duhen të raportohen do të përcaktohen me Urdhër të Ministrit.
4. Me qëllim që të përmbushin detyrimin e tyre për mbajtjen e rezervave, operatorët e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni duhet të ruajnë rezervat përkatëse të sigurisë në territorin e Republikës së Shqipëri.
5. Neni 9 dhe neni 25, pika 1, gërma b) e ligjit nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, zbatohen përsa nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji.

Neni 25

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11 pika 2, 17 pika 3 dhe 20 pika 4.

Ngarkohet ministria përgjegjëse për hidrokarburet që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4.2, 9, 10.1, 14.6 dhe 24.3.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më _____.